

Klan

LEKË 300, 3 EURO

NR 718 VITI XV 3 QERSHOR 2011



Nga e djathta, ambasadorët Arvizu, Volfarth dhe Sekul

DOSSIER

HISTORIA E 25 VJEÇARIT QË U VRA NGA SIM

Jetën për flamur

Shahin Toçi, 25 vjeçari nga Mati që refuzoi të kryente betimin ushtarak para flamurit italian në Romë. Djaloshi që kaloi gjysmën e jetës në akademitë ushtarake dhe vrasja e tij më 25 maj 1939. Flet nipi për peripecitë e gjetjes së eshtrave

NGA SEBI ALLA

Ishte vetëm 25 vjeç, kishte kohë që e mendonte momentin kur do vijej para flamurit italian. Para simbolit të atij shteti që i kishte pushtuar dhe poshitur atdheun. Me urrye dukshëm të shprehur, Shahin Toçi pikërisht në ditën kur do bëhej betimi si ushtarak do bënte një gjest që i kushtoi jetën në mes të Romës. Kapitani i ri hoqi uniformën e akademisë italiane dhe veshi ato shqiptare, duke rrethuar gjoksin edhe me një shirit kuq dhe zi. "Mund të nderohen dhe uniformat, por jo flamuri, atdheu mbetet po ai. Mjerë kush nuk e kupton këtë dhe e tradhëton flamurin dhe atdheun e tij. Ne i biem në gjunjë vetëm flamurit tonë, vetëm shqiptojnë tonë i falem!" Këto ishin fjalët e Shahin Toçit drejtuar nënsekretarit italian të ministrisë së Luftës. Gjenerali shtangu, por Toçi vijoi më tej kur në mënyrë demonstrative jo vetëm refuzoi betimin para flamurit italian, ku për gjashtë vite kishte studiuar, por me gjestin e tij bëri që edhe studentët e tjerë shqiptarë të shingeshin nga betimi. Për italianët kishte dy rrugë: Te debonin Toçin, ose ta eliminonin fizikisht. Zgjodhën rrugën e dytë, me të qetë për ta duke qenë të bindur se pasi të shkelte në Shqipëri, ky njeri do të ishte një bërë e madhe për pushtimin fashist. Dhe qëlon të takohemi me nipin e Shahin Toçit më 25 maj, pikërisht në 72-vjetorin e

vrasjes së tij në Romë.


I lindur dhe rritur në krahinën e Matit, Shahin Toçi nuk ishte ajo pjesë e ushtrisë që ushqente vetëm njënjë të forta monarkike, por mbi gjithçka ato patriotike. Lindi më 15 prill 1914 në fshatn Urxallë të Matit. Shkollën fillore e kryen në vendlindje dhe më pas fiton një bursë për në akademi ushtarake mbretërore. Për shkak të nderhyrjeve nga drejtues vendore, Toçit i mohohet kjo e drejtë studimi dhe detyrohet të udhëtojë nga Mati drejt Tiranës. Ishte vetëm 13 vjeçar dhe inerr rrugën më këmbë duke e mbajtur frymën para godinës mbretërore. Oficerët e mbretit e pyesin djalosin se përse kishte ardhur dhe i mundësojnë një takim të shkurtër me mbretin. I mituri e kishte të qartë atë që kërkonte: "Dua të shkollohem, nalmadhani!" Nuk kaloi gjatë dhe Shahin Toçi regjistrohet në akademi. Gjatë viteve 1930-1934 përfundon studimet në shkollën Mbretërore Ushtarake, duke rënë në sy për përgatitjen e tij teorike dhe praktike. Mirëpo synimet e tij ishin të qarta. Si enderr kishte të shkonte me studime më të thelluara jashtë vendit. Teksa ishte në shkollën mbretërore, përveçses mure gjuhën italiane, pasi shteti ynë kishte një marrëveshje për pranimin e studentëve shqiptarë. Në vitin 1934 pranohet në



kolegjin ushtarak të Napolit në Itali. Gjatë tre viteve të qëndrimit në Napoli mori studime të mirëfillta në artin ushtarak të këmbësorisë dhe kavalerisë. Kthehet në vendlindje në vitin 1937, tashmë si një ushtarak i mirëfilltë. Por specializimi i tij nuk kishte përfunduar ende. Qëndron pak muaj tek prindërit në Mat dhe më pas pak muaj punon në ministrinë e Mbrojtjes, por nisit sërish me specializimin në Romë. Kurikulumi i tij ishte i pasur dhe konkurrenca ishte fituar, duke treguar se mund të ishte një nga ushtarakët e aftë të se ardhmë. Masha e re dhe dëshira për të qenë pjesë e specializimeve moderne të kohës e bëri që të vendosje në kryeqytetin italian në vitin 1937. Iku me shpresën e kthimit në një gradë më të madhe, por nuk u këmbëz në i gjallë sepse Italia nga një vend mik u kthye në armik për vendin e vogël. Data shtatë prill, që perkon me ditën e pushtimit italian të Shqipërisë, Toçin dhe një grup gjeter të oficerëve të rinj e gjejnë në Romë



Shahin Toçi (në rreth) me kolegjet e tij në akademinë ushtarake të Modenas. Në krah, letra e fundit që 25-vjeçari i nisi familjes së tij. Në faqen tjetër, kapiten Shahin Toçi, pak kohë para të nisjes për në Romë. Poshtë, Shahin dhe Osman Toçi, dy nipërit që mundësovan ardhjen e eshtrave në vendlindje



kolegjin ushtarak të Napolit në Itali. Gjatë tre viteve të qëndrimit në Napoli mori studime të mirëfillta në artin ushtarak të këmbësorisë dhe kavalerisë. Kthehet në vendlindje në vitin 1937, tashmë si një ushtarak i mirëfilltë. Por specializimi i tij nuk kishte përfunduar ende. Qëndron pak muaj tek prindërit në Mat dhe më pas pak muaj punon në ministrinë e Mbrojtjes, por nisit sërish me specializimin në Romë. Kurikulumi i tij ishte i pasur dhe konkurrenca ishte fituar, duke treguar se mund të ishte një nga ushtarakët e aftë të se ardhmë. Masha e re dhe dëshira për të qenë pjesë e specializimeve moderne të kohës e bëri që të vendosje në kryeqytetin italian në vitin 1937. Iku me shpresën e kthimit në një gradë më të madhe, por nuk u këmbëz në i gjallë sepse Italia nga një vend mik u kthye në armik për vendin e vogël. Data shtatë prill, që perkon me ditën e pushtimit italian të Shqipërisë, Toçin dhe një grup gjeter të oficerëve të rinj e gjejnë në Romë

Ato orë që ishin bashkë e bisedonin të shqetësuar, u duk qartë se Toçi po oxiste bashkëpatriotët të mos rrinin duarkry përballë fashizmit. Kjo kishte rënë në sy të agjentëve të kudondodhur. Gjenden dokumenta në arkivën e ushtrisë italiane që vërtetojnë se studentët shqiptarë ishin të surjuar. Por sprova më e madhe për ushtarakët tanë do të vinte më datën 24 maj. Ishte parashikuar që të bëhej një ceremoni e beutimit të pjesëtarëve të akademisë para flamurit italian. Këtë Shahin Toçi e kishte të qartë. Nga valishtë e tij të vjetra, të bëra me dërrasat e latuara të vendlindjes nxorri uniformën ushtarake shqiptare. Mbante gradën e kapitenit pasi

ishte ende i ri dhe deri në atë kohë vetëm kishte studiuar. Përçap gjoksit vendosi një shirit kuqezij dhe zuri radhët e para të studentëve. Ra menjëherë në sy dhe komandanti i trupës së nderi i bëri thirrje të afrohej dhe betohej para flamurit italian. E kishte të qartë çfarë e prishte, por nuk hezitoi të thoshte atë që mundonte prej kohe: "Ne i biem në gjunjë vetëm flamurit tonë, vetëm shqiptonjës i falem!" Ushtrarakët madhorë italianë, u munduan ta zbulonin momentin, por fjalët e tyre shkuan kot. 25 vjeçari ishte i bindur për atë çfarë po bënte. Tashmë në një vend armik, me të mund të ndodhte gjithçka, ndaj vendosi të shpillohej në dhomën e tij dhe të mbanë shënime personale për atë çfarë kishte ndodhur në Akademi. Diku nga mesi i nates, në shtetnën e studentëve degjohen disa të shtetnë të mbytura. Pabesisht ishin futur në fjetje punonjës të policisë sekrete fashiste. Plumbat e lëshuara drejt Shahin Toçit ishin një oshetimë e cullë për veshjet e ushtarakeve të tjerë shqiptarë që mund të ngrinin krye, duke u treguar se fati i tij mund t'i prishte edhe ata. Trupi i Shahin Toçit u gjet pak orë më pas i pajetë dhe u lajmëruan strukturat e policisë ushtarake. Prania e studentëve të tjerë shqiptarë, bëri që komanda të udhërohej që t'i largonin me forcë. Në mediat e kohës në Itali jepet një lajm i shkurtër se Shahin Toçi ishte zhdukur, madje thuhet edhe se një ditë më parë kishte refuzuar të betohej para flamurit fashist. Në mënyrë të fshetë trupi i tij varoset në Verano të Romës. Dikush duhet të shkonte në Mat dhe t'i jepte lajmin e kobshëm familjes. U priten nga i an i mosuar i Shahinut. Teksa pinte kafë në oxhakun e kullës, e kuptoi se ata burra nuk kishin ardhur për murë. "Kryet shëndoshë për Shahinin o Osman Toçi, ai vdiq si barë", i thotë një bashkafshatar. I modhuari mbledh veten e sus mormin. Plot 40 ditë kulla u mbajt hapur në familjen e Shahinut, për t'i bërë nderimet. Kerkohej trupi i tij, por Osmanit i thonë se në gusht duhet të shkonte në Durres

HISTORIA E 25 VJEÇARIT QË U VRA NGA SIM

Jetën për flamur

Shahin Toçi, 25 vjeçari nga Mati që refuzoi të kryente betimin ushtarak para flamurit italian në Romë. Djaloshi që kaloi gjysmën e jetës në akademitë ushtarake dhe vrasja e tij më 25 maj 1939. Flet nipi për peripecitë e gjetjes së eshtrave

NGA SEBI ALLA

Ishte vetëm 25 vjeç, kishte kohë që e mendonte momentin kur do vihej para flamurit italian. Para simbolit të atij shteti që i kishte pushtuar dhe poshtëruar atdheun. Me urrejtje dukshëm të shprehur, Shahin Toçi pikërisht në ditën kur do bëhej betimi si ushtarak do bënte një gjest që i kushtoi jetën në mes të Romës. Kapiteni i ri hoqi uniformën e akademisë italiane dhe veshi ato shqiptare, duke rrethuar gjoksin edhe me një shirit kuq dhe zi. "Mund të ndërrohen dhe uniformat, por jo flamuri; atdheu mbetet po ai. Mjerë kush nuk e kupton këtë dhe e tradhëton flamurin dhe atdheun e tij. Ne i biem në gjunjë vetëm flamurit tonë, vetëm shqiptonjës tonë i falem!" Këto ishin fjalët e Shahin Toçit drejtuar nënsekretarit italian të ministrisë së Luftës. Gjenerali shtangu, por Toçi vijoi më tej kur në mënyrë demonstrative jo vetëm refuzoi betimin para flamurit italian, ku për gjashtë vite kishte studiuar, por me gjestin e tij bëri që edhe studentët e tjerë shqiptarë të shmangeshin nga betimi. Për italianët kishte dy rrugë: Të dëbonin Toçin, ose ta eliminonin fizikisht. Zgjedhën rrugën e dytë, më të qetë për ta duke qenë të bindur se pasi të shkëlte në Shqipëri, ky njeri do të ishte një bela e madhe për pushtimin fashist. Dhe qëllon të takohemi me nipin e Shahin Toçit më 25 maj, pikërisht në 72-vjetorin e




vrasjes së tij në Romë.

I lindur dhe rritur në krahinën e Matit, Shahin Toçi nuk ishte ajo pjesë e ushtrisë që ushqente vetëm ndjenja të forta monarkike, por mbi gjithçka ato patriotike. Lindi më 15 prill 1914 në fshatin Urxallë të Matit. Shkollën fillore e kryen në vendlindje dhe më pas fiton një bursë për në akademinë ushtarake mbretërore. Për shkak të ndërhyrjeve nga drejtues vendorë, Toçit i mohohet kjo e drejtë studimi dhe detyrohet të udhëtojë nga Mati drejt Tiranës. Ishte vetëm 13 vjeçar dhe merr rrugën më këmbë duke e mbajtur frymën para godinës mbretërore. Oficerët e mbretit e pyesin djalosin se përse kishte ardhur dhe i mundësojnë një takim të shkurtër me mbretin. I mituri e kishte të qartë atë që kërkonte: "Dua të shkollohem, naltmadhni!" Nuk kaloi gjatë dhe Shahin Toçi regjistrohët në akademi. Gjatë viteve 1930-1934 përfundon studimet në shkollën Mbretërore Ushtarake, duke rënë në sy për përgatitjen e tij teorike dhe praktike. Mirëpo synimet e tij ishin të qarta. Si ëndërr kishte të shkonte me studime më të thelluara jashtë vendit. Teksa ishte në shkollën mbretërore, përvetëson mirë gjuhën italiane, pasi shteti ynë kishte një marrëveshje për pranimin e studentëve shqiptarë. Në vitin 1934 pranohet në

kolegjin ushtarak të Napolit në Itali. Gjatë tre viteve të qëndrimit në Napoli mori studime të mirëfillta në artin ushtarak të këmbësorisë dhe kavalerisë. Kthehet në vendlindje në vitin 1937, tashmë si një ushtarak i mirëfilltë. Por specializimi i tij nuk kishte përfunduar ende. Qëndron pak muaj tek prindërit në Mat dhe më pas pak muaj punon në ministrinë e Mbrojtjes, por nisët sërish me specializim në Romë. Kurrikulumi i tij ishte i pasur dhe konkurset në shkollat e njohura ushtarake të Italisë i kishte fituar, duke treguar se mund të ishte një nga ushtarakët e aftë të së ardhmes. Moshë e re dhe dëshira për të qenë pjesë e specializimeve moderne të kohës e bëjnë që të vendosej në kryeqytetin italian në vitin 1937. Iku me shpresën e kthimit me një gradë më të madhe, por nuk u kthye më i gjallë sepse Italia nga një vend mik, u kthye në armike për vendin e vogël. Data shtatë prill, që përkon me ditën e pushtimit italian të Shqipërisë, Toçin dhe një grup tjetër të oficerëve të rinj e gjejnë në Romë.





Shahin Toçi (në rreth) me kolegët e tij në akademinë ushtarake të Modenas. Në krah, letra e fundit që 25-vjeçari i nisi familjes së tij. Në faqen tjetër, kapiten Shahin Toçi, pak kohë pasi të nisej për në Romë. Poshtë, Shahin dhe Osman Toçi, dy nipërit që mundësuan ardhjen e eshtrave në vendlindje

personale për atë çfarë kishte ndodhur në Akademi. Diku nga mesi i natës, në fjetinën e studentëve dëgjohej disa të shtëna të mbytura. Pabesisht ishin futur në fjetinë punonjës të policisë sekrete fashiste. Plumbat e lëshuara drejt Shahin Toçit ishin një oshëtimë edhe për veshët e ushtarakëve të tjerë shqiptarë që mund të ngrinin krye, duke u treguar se fati i tij mund t'i priste edhe ata. Trupi i Shahin Toçit u gjet pak orë më pas i pajetë dhe u lajmëruan strukturat e policisë ushtarake. Prania e studentëve të tjerë shqiptarë, bëri që komanda të urdhërohej që t'i largonin me forcë. Në mediat e kohës në Itali jepet një lajm i shkurtër se Shahin Toçi ishte zhdukur, madje thuhet edhe se një ditë më parë kishte refuzuar të betohej para flamurit fashist. Në mënyrë të fshehtë trupi i tij varrosët në Verano të Romës. Dikush duhet të shkonte në Mat dhe t'i jepte lajmin e kobshëm familjes. U pritën nga i ati i moshuar i Shahinit. Teksa piqte kafe në oxhakun e kullës, e kuptoi se ata burra nuk kishin ardhur për mirë. "Kryet shëndoshë për Shahinin o Osman Toçi, ai vdiq si burrë", i thotë një bashkafshatar. I moshuari mbledh veten e nis mortin. Plot 40 ditë kulla u mbajt hapur në familjen e Shahinit, për t'i bërë nderimet. Kërkohej trupi i tij, por Osmanit i thonë se në gusht duhet të shkonte në Durrës ▶

Ato orë që ishin bashkë e bisedonin të shqetësuar, u duk qartë se Toçi po nxiste bashkëpatriotët të mos rrinin duarkryq përballë fashizmit. Kjo kishte rënë në sy të agjentëve të kudonodhur. Gjenden dokumenta në arkivën e ushtrisë italiane që vërtetojnë se studentët shqiptarë ishin të survejuar. Por prova më e madhe për ushtarakët tanë do të vinte më datën 24 maj. Ishte parashikuar që të bëhej një ceremoni e betimit të pjesëtarëve të akademisë para flamurit italian. Këtë Shahin Toçi e kishte të qartë. Nga valixhet e tij të vjetra, të bëra me dërrasat e latuara të vendlindjes nxorri uniformën ushtarake shqiptare. Mbante gradën e kapitenit pasi

ishte ende i ri dhe deri në atë kohë vetëm kishte studiuar. Përqark gjoksit vendosi një shirit kuqezi dhe zuri radhët e para të studentëve. Ra menjëherë në sy dhe komandanti i trupës së nderit i bëri thirrje të afrohej dhe betohej para flamurit italian. E kishte të qartë çfarë e priste, por nuk hezitoi të thoshte atë që mundonte prej kohe: "Ne i biem në gjunjë vetëm flamurit tonë, vetëm shqiponjës i falem!" Ushtarakët madhorë italianë, u munduan ta zbusnin momentin, por fjalët e tyre shkuan kot. 25 vjeçari ishte i bindur për atë çfarë po bënte. Tashmë në një vend armik, me të mund të ndodhte gjithçka, ndaj vendosi të shplohdej në dhomën e tij dhe të mbante shënime

Pas 72 vjetësh
eshtrat e dëshmorit
të atdheut kthehen
në Shqipëri. Në
krah, Shahin Toçi
në momentin që
shërbente në Mini-
strinë e Mbrojtjes.
Poshtë, të afërm
bëjnë homazhe
pranë varrit të tij



dhe të merrte sendet personale të djalit, pasi kufoma nuk mund t'i kthehej. Shtatë valixhet e mëdha mbanin sendet personale dhe rrobat e Shahimit. Ndërsa një ushtarak kalabrez i thotë Osmanit se djali u vra si dëshmor.

Një pjesë të sendeve personale i kemi ndër duar ndërsa na i tregon nipi i Shahinit, Osmani. Dy blloqe personale mbajnë të shkruar terma arkeologjikë dhe gjeografikë, duke u dhënë kuptimin e tyre. Ruhet edhe një letër e fundit që i kishte nisur familjes. Ajo mban datën 23 mars 1939, vetëm dy muaj para se të ekzekutohej nga strukturat e SIM-it. "Në shkollë u paraqita dhe kemi filluar rregullisht. Sikurse u çova fjalë kësaj radhe nuk mujta me j'u çue gja, sepse veç një rrogë kam marr...". Në letër ai tregon se paratë do i duhen për të ngrënë, fjetje dhe veshje, por u premtim të afërmit se në javët në vazhdim do t'u dërgojë të holla. Pasi të marrë rrogat e tjera. Por në fakt do ishte paga e parë dhe e fundit që mori. Sepse sikurse del nga dokumentet, Toçi u ekzekutua nga strukturat e SIM për shkak të refuzimit të betimit para flamurit fashist dhe për frymën antifashiste që kishte nxitur me bashkëkombasit e tij.

Trupi i tij gjendej diku në një varrezë periferike të Romës. Dhe për familjen e këtij guximtari të rrallë nuk ishte aspak e lehtë. Pas vendosjes së sistemit komunist, në vitin 1961 dekorohet me urdhrin e trimërisë, ndërsa në vitin 1970 shpallet si dëshmor i atdheut. Megjithë nderimet e kohës, babanë e Shahinit po e brente dhimbja e moshës. Në vitin 1951

vdes dhe u lë amanet të bijve që të bënin çmos të rikthenin në vendlindje eshtrat e Shahimit. Do kalonin jo pak por 72 vjet për mbërritjen e një arkëze të vogël metalike me eshtrat e Shahin Toçit, ku në kafkën e tij shihet shenja e depërtimit të një plumbi vdekjeprurës.

Detyra për rikthimin e eshtrave në vendlindje u kishte mbetur nipërve të Shahinit. Osman e Shahin Toçi emigrojnë në Itali në fillim të viteve '90'. Pasi kishin siguruar pak të ardhura, nisën kërkimet në arkiva dhe në fund pas shumë peripecish gjejnë varrin e xhaxhait të tyre. "Në vitin 1993 gjetëm vendin ku ishte varrosur xhaxhai ynë dhe ky ishte një lehtësim i madh për ne. Vetëm një javë pasi gjetëm eshtrat e Shahinit, babai ndërroi jetë dhe përveç moshës nuk mundi të përballonte gjendjen emocionale". Kështu tregon Osman Shahini, nipi i patriotit të ri, që injoroi flamurin dhe betimin fashist. Por as në

kohët moderne nuk qe e lehtë kthimi i eshtrave. Nipi tregon një dosje të madhe me dokumentacionet që duhet të plotësojnë dhe lejet e shumta që duheshin marrë për rikthimin e eshtrave të kapitenit në atdhe. "Gjithçka e kemi kryer me kursimet tona, pasi e kishim detyrim dhe është një figurë që nuk i përket vetëm familjes Toçi, por gjithë Shqipërisë", shprehet Osmani. Ndihet i lehtësuar dhe përmend shpesh edhe strukturat shqiptare dhe deputetët e zonës së Matit që në ceremoninë e varrimit të eshtrave të Shahin Toçit në vendlindje kryen të gjithë nderimet shtetërore. Në ceremoninë e varrimit në Mat morën pjesë ministri i Mbrojtjes Arben Imami, personalitete të pushtetit lokal dhe mijra qytetarë të zonës. Tashmë eshtrat e atij të riu 25-vjeçar kanë zënë vend në varrezat e dëshmorëve në Mat.

Iku me një anije të vjetër nga Porti i Durrësit dhe pas 72-vjetësh u kthye në vendlindje si një grusht eshtra. Në disa foto që na tregon Osmani gjatë zhvarrimit në Itali, duket qartë edhe ajo arkëze e vogël që mban eshtrat e këtij patrioti që vërtet nuk shkrehu armë, por me gjestin e tij patriotik, u bë shembull i qindra të rinjve që kishin studiuar në akademitë e huaja ushtarake dhe u kthyen për të luftuar për çlirim të vendit. Amaneti i babait të 25-vjeçarit u çua në vend. Tashmë prehet në tokën ku lindi dhe u rrit. Një jetë e humbur për flamur.

